

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6203
E martë, 29 dhjetor 2020
çmimi 0.40 €

BE-ja ndan 70 milionë euro për vaksinat në Ballkanin Perëndimor

FAQE 8



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

KUVENDI I KOSOVËS KA MBAJTUR SEANCË TË JASHTËZAKONSHME PLENARE

FAQE 4-5

KUVENDI MIRATON PROJEKTBUXHETIN PËR VITIN 2021



Deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë miratuar të hënën në lexim të parë Projektbuxhetin për vitin 2021. Pas diskutimeve që ndodhën

mes deputetëve të pozitës dhe opozitës, ky projektbuxhet mori 64 vota për. Projektbuxhetin për vitin 2021 e kanë kundërshtuar

deputetët nga Lëvizja Vetëvendosje. Sipas projekteve, buxheti për vitin 2021 kap vlerën 2.4 miliardë euro

MBI 39 MIJË ËSHTË NUMRI I TË SHËRUARVE NGA COVIDI NË KOSOVË

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike (IKShPK) ka njoftuar se të hënën në Kosovë janë shënuar edhe tetë raste të të vdekurve nga Covid-19. Në raportin ditor të IKShPK-së bëhet me dije se, bazuar në 1 002 mostra të

testuara nga personat e dyshuar me Covid, 181 kanë dalë pozitive. Me shifrat e fundit, numri i përgjithshëm i të infektuarve me Covid në Kosovë arrin në 50 801. Prej tyre, 1 317 pacientë kanë vdekur dhe 39 969 janë shëruar



AKTUALE

VENDET ANËTARE TË BE-së MBËSHTESIN MARRËVESHJEN ME BRITANINË E MADHE F. 11



FATON ABDULLAHU I BASHKOHET PDK-së F. 5

PREMTOHET NDIHMË FINANCIARE PËR GRATË NË BIZNES F. 6

NISIN HETIMET PËR HYRJEN E VAKSINAVE NË VERI F. 7

EKONOMI



BUXHETI I RËNDUAR I FAMILJEVE NË PANDEMI F. 9

PROKURORI TËRHIQET NGA NDJEKJA PENALE E SAFET KRASNIQIT, SHKAK MUNGESA E PROVAVE F. 8

SPORT

SOT PËRBALLEN PRISHTINA - PONTE PRIZRENI DHE VËLLAZNIMI - YLLI F. 12



KQZ-ja E KONSIDERON SFIDË ORGANIZIMIN E ZGJEDHJEVE TË REJA

FAQE 6

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçishtë-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Zgjerimi i Greqisë në Detin Jon, Meta: S'do të lejoj të cenohet interesi kombëtar



Tiranë, 28 dhjetor - Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, ka reaguar për herë të parë pas vendimit të Greqisë për t'u zgjeruar me 12 milje në Detin Jon, duke theksuar prerë se nuk do të lejojë për asnjë moment të cenohen interesat shtetërore dhe kombëtare. Në mesazhin e tij, Meta ka theksuar se nuk ka marrë asnjë njoftim apo kërkesë zyrtare që ta sugjerojë

ndërprerjen, pezullimin apo përfundimin e procesit të negociatave dypalëshe, nga ekipi negociator apo nga qeveria shqiptare. "I siguroj të gjithë qytetarët shqiptarë se do të vijoj të ushtroj me përgjegjësinë maksimale shtetërore dhe kushtetuese detyrat e mia dhe se nuk do të lejoj për asnjë moment të cenohen interesat shtetërore

dhe kombëtare të Republikës së Shqipërisë nga cilido individ, që keqpërdor autoritetin e deleguar nga populli shqiptar. Sipas traditës së vendosur, pasi të vihet në dijeni të plotë të informacioneve të kërkuara zyrtarisht, do t'i bëj plotësisht transparent vlerësimet dhe qëndrimet e mia në lidhje me të gjitha zhvillimet ndaj kësaj çështjeje", ka thënë Meta.

BE-ja ndan 70 milionë euro për vaksinat në Ballkanin Perëndimor

PRISHTINË, 28 DHJETOR - Komisioni Evropian ka ndarë sot 70 milionë euro nga instrumentet e paraanëtarësimit për t'i ndihmuar vendet e Ballkanit Perëndimor që t'i sigurojnë vaksinat kundër Covid-19 nga sasia e dozave që janë porositur nga shtetet anëtare të Bashkimit Evropian. Këto mjete janë shtesë, krahas atyre që BE-ja ka ndarë për programin e Organizatës Botërore të Shëndetësisë, COVAX, përmes të cilit shumë shtete të rajonit dhe të botës do të furnizohen me vakcina. Mjetet e ndara, në vlerë prej 70 milionë eurosh, do të përdoren për t'i blerë vaksinat për grupet prioritare nga gjashtë prodhues me të cilët Komisioni Evropian ka marrëveshje, por edhe për pajisjet e nevojshme në rajon për programin e vaksinimit.

Vaksinimi në shtetet e BE-së tashmë ka nisur, pasi dozat e para të vaksinës janë siguruar nga Komisioni Evropian. BE-ja ka thënë se synon që nga sasia e vaksinave, që është dedikuar për shtetet anëtare, një pjesë të ndahet edhe për vendet e Ballkanit Perëndimor, pasi vaksinat përmes programit COVAX pritet të arrijnë më vonë gjatë vitit 2021. Sipas Komisionit Evropian, vaksinat e para në rajon do të vijnë nga sasia e dedikuar për shtetet anëtare të BE-së, për të mbuluar një zbrastetirë deri tek arritja e sasive më të mëdha. "Qasja në një sasi të dozave nga programi i porositur të BE-së do t'i mundësojë rajonit që ta nisë vaksinimin paralelisht me vendet anëtare të BE-së", thuhet në komunikatën e Komisionit Evropian. Komisionari për Zgjerim, Oliver Verhelyi, e ka quajtur

këtë vendim si dëshmi për partneritet të privilegjuar që BE-ja ka me vendet e rajonit të Ballkanit Perëndimor. "Gjatë gjithë pandemisë, BE-ja ka dëshmuar se e trajton Ballkanin Perëndimor si partner të privilegjuar. Ne vazhdojmë të veprojmë në këtë frymë edhe kur është çështja të vaksinat, duke ndërmarrë hapa për të siguruar nisje të shpejtë të fushatës së vaksinimit për stafin kyç dhe grupet më të rrezikuara në rajon sa më parë që të jetë e mundur. Vaksinimi i shpejtë do të jetë vendimtar për t'i dhënë fund pandemisë dhe për ta nisur rimëkëmbjen socio-ekonomike në Ballkanin Perëndimor", ka thënë Verhelyi. Kosova është pjesë e programit COVAX dhe autoritetet në Prishtinë kanë thënë se presin që të sigurojnë vakcina kundër Covid-19 për 20 për qind të popullatës nga ky program.



Programi COVAX ka për qëllim që të sigurojë 2 miliardë doza të vaksinës deri në fund të vitit 2021, përfshirë 1.3 miliard të cilat do t'u dërgohen shteteve në zhvillim. Në rajon, është Serbia që ka

nisur programin e vaksinimit me vaksinën e prodhuar nga kompanitë "Pfizer" dhe "BioNTech", pasi ditë më parë arriti dërgesa e parë e vaksinave. Serbia pret që të pranojë edhe dërgesa të reja.

Kreu i OBSH-së: Pandemia Covid-19 nuk do të jetë e fundit që do të kalojmë

GENEVË, 28 DHJETOR - Sipas kreut të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, dr. Tedros Adhanom Ghebreyesus, pandemia e Covid-19 nuk do të jetë e fundit që do ta kalojmë. Ai për këtë çështje ka folur në fjalimin virtual në Ditën Ndërkombëtare të Gatishmërisë për Epideminë, e cila mbahet

çdo vit nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara. "Në 12 muajt e fundit bota është kthyer përmby. Ndikimet e pandemisë shkojnë shumë përtej vetë sëmundjes, me pasoja të mëdha për shoqëritë dhe ekonomitë. Historia na tregon se kjo nuk do të jetë pandemia e fundit", ka



thënë kreu i OBSH-së. Ai ka paralajmëruar të gjitha vendet të investojnë në kapacitete për të parandaluar, zbuluar dhe zbutur emergjencat e të gjitha llojeve, edhe nëse do të jetë një tjetër pandemi globale që do të na godasë. Në fund ai tha se bota duhet të mësojë nga e shkuara në mënyrë që të jetë më

e përgatitur. Aktualisht numri total i rasteve të infektiveve nga Covid-19 ka arritur 81,150,518, ndërkohë që numri i viktimave është 1,772,114 në të gjithë botën që nga fillimi i pandemisë. Ndërkohë vaksinimi ka nisur në shumë vende të botës, që përbën një arritje pas një viti "lufte" me Covid-19.

Shqipëria ndihmon financiarisht në disa projekte shqiptarë në Mal të Zi dhe në Luginë



TIRANË, 28 DHJETOR (ER) - Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme të Shqipërisë, Gent Cakaj, ka bërë me dije se në përputhje me përpjekjen e Qeverisë së Shqipërisë për t'iu dhënë mbështetje të gjithë shqiptarëve në rajon,

veçanërisht atyre në Mal të Zi e në Luginë të Preshevës, shqiptarëve në këto dy vende do t'u ndahet ndihmë financiare në disa projekte sipas kërkesave të këshillave kombëtare shqiptarë. "Më konkretisht, ne do t'i

mbështesim projektet për organizim të kurseve për mësimin e gjuhës shqipe për nxënësit shqiptarë në Tivar, fushatën sensibilizuese për deklarimin e identitetit kombëtar në procesin e censusit të 2021-s në Mal të Zi,

projektin e ndihmës juridike falas kundër procesit të pasivizimit të adresave të shqiptarëve dhe disa propozime nga shoqëria civile e Luginës së Preshevës, për ta gjallëruar punën e tyre të vyer", ka thënë Cakaj.

Hoti dhe Varhelyi biseduan për zhvillimet politike dhe pandeminë Covid-19

EPOKA ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 28 DHJETOR - Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, në një bisedë telefonike me komisionarin për Fqinjësi dhe Zgjerim, Oliver Varhelyi, ka diskutuar për zhvillimet aktuale politike në vend dhe situatën me pandeminë Covid-19. Hoti e ka siguruar Varhelyin se Kosova do të vazhdojë të ketë stabilitet institucional dhe fiskal do ta trajtojë me prioritet menaxhimin e pandemisë Covid-19 dhe do t'i kryejë të gjitha obligimet që dalin karshi procesit të integritetit të vendit në Bashkimin Evropian.

Kryeministri Hoti me këtë rast e ka falënderuar Varhelyin edhe për përkrahjen për lansimin dhe zbatimin e Agjendës për Reforma Evropiane ERA 2.

Sa i përket sigurimit të vaksinës kundër Covid-19, Varhelyi e siguroi kryeministrin Hoti se një sasi e saj do të arrijë në Kosovë në të njëjtën kohë

sikurse në vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor. Të dy bashkëbiseduesit ngritën shqetësimin për hyrjen ilegale të vaksinës kundër Covid-19 në Kosovë, pa procedura të rregullta të importit apo donacionit për produkte mjekësore, për të cilat nuk dihet as origjina. Kjo sjellje e Republikës së Serbisë u konsiderua e papranueshme dhe institucionet e Kosovës kanë iniciuar veprimet e nevojshme ligjore ndaj personave të përfshirë në këto veprime. Kryeministri Hoti e siguroi komisionarin Varhelyi se në kuadër të planeve për vaksinim janë përfshirë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës pa asnjë dallim. Kryeministri Hoti falënderoi gatishmërinë e institucioneve të Bashkimit Evropian që ta vazhdojnë mbështetjen e pakursyer për institucionet dhe qytetarët e Kosovës për menaxhimin e krizës të cilën e ka shkaktuar pandemia Covid-19.



Turqia mbështet një Kosovë të fortë dhe anëtare të NATO-s si garanci e sigurisë në Evropën Juglindore

Ministrja e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës, Meliza Haradinaj-Stublla, po qëndron për vizitë në Turqi. Ajo është takuar të hënën me homologun e saj, ministrin e Punëve të Jashtme të Turqisë, Mevlut Çavusoglu. Ministrja Haradinaj-Stublla ka kërkuar përkrahjen e Turqisë në përmbylljen e njohjes universale të shtetit të Kosovës si anëtare me të drejta dhe përgjegjësi të plota në bashkësinë ndërkombëtare

EPOKA ERE

Faton DËRMAKU

ANKARA, 28 DHJETOR - Një Kosovë e fortë dhe e integruar në NATO është garanci e sigurisë në Evropën Juglindore ka thënë të hënën ministrja e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës e Kosovës, Meliza Haradinaj-Stublla, në takim zyrtar që ka zhvilluar në Ankara me homologun e saj, ministrin e Punëve të Jashtme të Turqisë, Mevlut Çavusoglu.

Shefja e diplomacisë e Kosovës ka pohuar se është mirënjohëse për mbështetjen shumëdimensionale dhe të pandërprerë të Turqisë, veçanërisht për forcimin e subjektivitetit ndërkombëtar të

Republikës së Kosovës.

Në takim me ministrin Çavusoglu, ministrja Haradinaj-Stublla ka thënë se janë diskutuar të gjitha aspektet e raporteve bilaterale midis të dy shteteve, duke ngritur me prioritet çështjen e qasjes në vaksinën anti-Covid dhe mbështetjen për bashkëpunim të ngushtë në këtë drejtim.

Në kuadër të diskutimit për zhvillimet rajonale dhe ndërkombëtare, kryediplomatja Haradinaj-Stublla ka kërkuar përkrahjen e mëtejme të Turqisë për përmbylljen e njohjes universale të shtetit të Kosovës si anëtare me të drejta dhe përgjegjësi të plota në bashkësinë ndërkombëtare. "E sigurova homologun se një Kosovë e fortë



brenda, e integruar në NATO dhe e njohur ndërkombëtarisht, është garanci e fortë e sigurisë dhe stabilitetit në Evropën Juglindore. Njëherësh u sigurova nga ministri Çavusoglu se Turqia do ta vazhdojë mbështetjen e plotë për Kosovën në këtë aspekt. Gjithashtu, treguam gatishmëri

për thellimin e mëtejme të marrëdhënieve në aspektin e sigurisë dhe atë ushtarak, sidomos për aspiratën legjitime të Kosovës për avancimin e rrugëtimit të saj integruar në NATO, duke përmbyllur kështu arkitekturën e sigurisë në brezin e Adriatikut", ka thënë ajo.

Ministrat diskutuan edhe për nevojën e rritjes së aktivitetit ekonomik midis dy shteteve dhe përmirësimin e bilancit tregtar. Ministri Çavusoglu u shpreh se në këtë kuadër do të rriten investimet turke në Kosovë si dhe do të mundësohen kushtet për rritjen e eksportit të Kosovës drejt Turqisë.



KUVENDI I KOSOVËS KA MBAJTUR SEANCË TË JASHTËZAKONSHME PLENARE

KUVENDI MIRATON PROJEKTBUXHETIN PËR VITIN 2021

Deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë miratuar të hënën në lexim të parë Projektbuxhetin për vitin 2021. Pas diskutimeve që ndodhën mes deputetëve të pozitës dhe opozitës, ky projektbuxhet mori 64 vota për. Projektbuxhetin për vitin 2021 e kanë kundërshtuar deputetët nga Lëvizja Vetëvendosje. Sipas projekteve, buxheti për vitin 2021 kap vlerën 2.4 miliardë euro

me pandeminë”, ka deklaruar Bajrami, duke bërë me dije se pa miratimin e këtij projektbuxheti nuk mund të zbatohet edhe Ligji për Rimëkëmbje Ekonomike, i miratuar më 4 dhjetor, që ka për qëllim rimëkëmbjen ekonomike të shkaktuara nga pandemia e koronavirusit. “Është paraparë Fondi për rimëkëmbje prej 182 milionë eurosh. Një pjesë e konsiderueshme është destinuar për sektorin e shëndetësisë, shpenzime këto të cilat janë të ndërlydhura me mbulimin e kostos së vaksinës dhe shpenzime të tjera për përballje me pandeminë. Ky sektor do të ketë buxhet më të madh për vitin 2021”, është shprehur ministri Bajrami. Projektbuxhetin për vitin 2021 e kanë kundërshtuar deputetët nga Lëvizja Vetëvendosje. Liburn Aliu, në emër të grupit parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, ka thënë se qeveria në detyrë e udhëhequr nga Avdullah Hoti, nuk ka të drejtë të sjellë në Kuvend Projektbuxhetin 2021 për shkak se është jolegjitimë. Sipas tij, në projektbuxhetin aktual nuk ka rritje të mjeteve për sektorin e shëndetësisë dhe arsimit, por ky buxhet është fokusuar në infrastrukturë. “Dhe ju përpigëni që shpejt e më

shpejtë të bëni edhe diçka më zi. Prandaj, që në fillim legjitimiteti juaj nuk ekziston. Ju nuk keni të drejtë të sillni projektbuxhet. Dhe po vazhdoni të bëni zi edhe këto pak ditë që ju kanë mbetur. E kjo zi, që po mundoheni ta bëni, është me këtë projektbuxhet që keni sjellë”, ka deklaruar Aliu. Shefi i grupit parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Bedri Hamza, ka kritikuar përgatitjen e projektbuxhetit, duke theksuar se ky është buxheti më i dobët që është përgatitur ndonjëherë nga një qeveri. Ai ka thënë se, pavarësisht kësaj, PDK-ja do votojë për interesa të qytetarëve në mënyrë që mos të bllokohet shteti. Deputeti Hamza ka theksuar se është i domosdoshëm rishikimi i buxhetit nga qeveria e re që do të dalë pas zgjedhjeve të parakohshme parlamentare. “Ne do të votojmë buxhetin me gjithë këto vërejtje, jo për qeverinë sepse qeveria ka rënë dhe vendi shkon në zgjedhje. Kam dëgjuar se ka kohë për ta votuar buxhetin. Por, nëse zgjedhjet mbahen në fillim të muajit janar dhe në fillim të muajit shkurt, derisa të certifikohen zgjedhjet e dimë se sa kohë shkon. Pastaj, deri në konstituimin e institucioneve do

ta lëmë vendin pa buxhet dhe në bllokadë totale. Për ne ka qenë prioritet shteti dhe interesi i qytetarëve dhe për këtë do të votojmë”, ka thënë Hamza. Deputeti i AAK-së, Gazmend Abrashi, ka thënë se Ligji për Rimëkëmbjen Ekonomike, zbatim i të cilit do të mundësohet nga votimi i këtij projektbuxheti, do t'i lehtësojë humbjet financiare që kanë ndodhur. “Përmes lirimeve dhe lehtësirave fiskale, që pritet t'i bëhet sektorit privat, do të jetë stimulim shtesë për shtimin e aktivitetit ekonomik, mbajtjen e vendeve ekzistuese të punës dhe krijimin potencialisht të vendeve të reja të punës, të cilat masa pritet të kenë ndikim edhe në rritjen agregate dhe rritjen e të hyrave buxhetore”, ka thënë ai. Projektligji për buxhetin e vitit 2021 kap vlerën e 2.4 miliardë eurove. Nëse buxheti nuk miratohet deri më 31 dhjetor, Kuvendi, me anë të një vendimi mund ta autorizojë vazhdimin e zbatimit të Ligjit për ndarjet buxhetore të vitit të kaluar fiskal. Shpërndarja e Kuvendit të Kosovës pritet të ndodhë pas publikimit të aktgjykimit të plotë të Gjykatës Kushtetuese, e cila më 21 dhjetor ka kontaktuar se qeveria e udhëhequr nga Avdullah Hoti është zgjedhur në mënyrë jokushtetuese.

**EPOKA
ERE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 28 DHJETOR - Me 64 vota për deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë miratuar të hënën në parim Projektligjin për buxhetin e vitit 2021. Për miratimin në lexim të parë të këtij projektligji nuk votuan deputetët e Lëvizjes Vetëvendosje, kurse më 29 dhjetor pritet që të votohet në lexim të dytë ky projektligji. Deputetët e Kuvendit të Kosovës, të pozitës dhe të opozitës, debatuan rreth Projektligjit për buxhetin për vitin 2021. Seanca e jashtëzakonshme u thirr nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me qëllim që të miratohet buxheti përpara se të shpërndahej Kuvendi dhe të mbahen zgjedhjet e jashtëzakonshme parlamentare. Ministri e Financave, Hykmete

Bajrami, para votimit të projektbuxhetit u ka bërë thirrje deputetëve që ta votojnë këtë projektbuxhet në mënyrë që të mos bllokohen institucionet e Kosovës. Ajo ka thënë se Projektbuxheti për vitin 2021 trajton dy prioritete: përballjen me pandeminë dhe krijimin e kushteve për rimëkëmbjen e ekonomisë. “Të nderuar deputetë, miratimi i këtij projektligji sot do të dërgojë sinjal të duhur te komuniteti i biznesit dhe në masë të madhe do ta zvogëlojë pasigurinë eventuale në ekonomi, e cila mund të shfaqet nëse kjo legjislaturë do të shpërndahej pa miratuar buxhetin 2021. Po ashtu, miratimi i këtij Projektbuxheti dërgon sinjale pozitive edhe tek institucionet financiare ndërkombëtare dhe në përgjithësi te partnerët tanë ndërkombëtarë, që na kanë ndihmuar shumë në përballje

Faton Abdullahu i bashkohet PDK-së

Faton Abdullahu, në konferencën për media mbajtur në selinë e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), ka thënë se ka vendosur t'i bashkëngjitet kësaj partie, sepse PDK-ja ka hapur dyert për ide të reja, për njerëz të ri dhe për ndryshime të mëdha

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINE, 28 DHJETOR - Kandidati për kryeministër nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK-së), Enver Hoxhaj, ka paraqitur anëtarin më të ri të PDK-së, Faton Abdullahu. Hoxhaj, duke i uruar mirëseardhje Abdullahut, ka theksuar se Partia Demokratike është një shtëpi e madhe që së bashku me procesin e reformimit të brendshëm, po hapet edhe për intelektualët jashtë partisë, të cilët do ta kenë vendin dhe hapësirën e merituar në PDK. "Tani Kosova po kalon në faza të

vështira politike. Shteti ynë, i ndërtuar mbi shumë sakrifica, sot gjendet në udhëkryq. E kërcënuar së brendshmi nga populizmi dhe së jashtmi nga goditja ndaj UÇK-së dhe shtetësisë, Kosova ka nevojë të udhëhiqet nga një parti e dëshmuar shtetformuese si PDK-ja", ka thënë ai, duke theksuar se për ta parandaluar zhbërjen e shtetit, PDK-ja do të garojë në këto zgjedhje në aleancë të gjerë me qytetarët dhe ekspertët e fushave të ndryshme që mund ta ndihmojnë vendin në këto çaste vendimtare. "PDK-ja po kthehet edhe një herë te baza, po dëgjon

pulsin e qytetarit, po i ndien kërkesat e tij dhe së bashku me të po e krijojnë një bllok të gjerë për ta parandaluar zhbërjen e shtetit dhe kthimin e shtetit në binarët e zhvillimit ekonomik dhe bashkëpunimit me aleatët perëndimorë, në krye me ShBA-në. Blloku i madh opozitar i koalicionit mes PDK-së dhe qytetarit është garanci e vetme për ta ruajtur shtetin dhe për ta rimëkëmbur Kosovën ekonomisht dhe kombëtarisht", është shprehur Hoxhaj.

Ndërkaq Faton Abdullahu, duke e falënderuar Hoxhaj për pritjen, ka thënë se ka vendosur t'i bashkëngjitet PDK-së, sepse kjo parti ka hapur dyert për ide të reja, për njerëz të ri, për ndryshime të mëdha. "Unë nuk kam trokitur në dyert e PDK-së. Ato i kam gjetur të hapura. Ato janë të hapura më shumë se kurrë për të gjithë ata që dëshirojnë t'i bashkohen këtij projekti për ndryshimin e vendit", ka thënë Abdullahu.

Si biri i ish të burgosurit politik Rexhep Abdullahu, Abdullahu ka theksuar se ADN-ja e tij politike dhe ADN-ja atdhetare e familjes së tij natyrshëm e lidhin me PDK-në. Sipas Abdullahut, PDK-së i është bërë një hile e madhe pasi partia po hyn në garë zgjedhore dhe pa kryetarin e saj Kadri Veselin, por që punët e filluara mbarë nga ai, idetë për reforma e ndryshime, strategjinë për ta luftuar krimin e korrupsionin dhe riparimi i raporteve me aleatët e vendit do t'i shtyjë përpara më fort se kurrë kryeministri i ardhshëm i Kosovës, Enver Hoxhaj. "Kosovës i duhet një kryeministër si z. Hoxhaj që e kupton drejt e mirë gjuhën euroatlantike e jo një kryeministër i cili nuk e gjen rrugën për në Uashington. Sot z. Hoxhaj është këtu sepse tek ai PDK-ja ka pa njeriun që krijon balancë me korrektësi dhe guxim dhe bashkon njerëz me urti e largpamësi. Kurrë më shumë nuk na është dashur një kryeministër i tillë i cili në p

ërballjen me të gjitha të këqijat e Kosovës, sidomos me rezikun nga Serbia, na bashkon dhe na balancon drejt e dobishëm me aleatët tanë. Edhe një herë faleminderit kryeministër i ardhshëm i Kosovës, juve dhe bashkëpunuesve tuaj për besimin dhe mundësinë! Dalshim faqebardhë bashkë me Kosovën dhe gjithë qytetarët e saj", ka thënë Abdullahu.

Faton Abdullahu ka lindur në Prishtinë, ku e ka kryer shkollën fillore dhe të mesme. Ai ka përfunduar Fakultetin Juridik në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina", ndërsa ka magjistruar për shkencë politike në njërin nga universitetet më të mira në Britani "UCL".

Faton Abdullahu është autor i disa librave dhe analist politik në mediat vendore, për të cilat edhe shkruan rregullisht kolumne. Ai ka qenë kryeredaktor dhe gazetar në disa media si në vend ashtu edhe jashtë vendit. Ka qenë zëdhënës i Qeverisë së Kosovës në vitin 2016/17.



KQZ-ja e konsideron sfidë organizimin e zgjedhjeve të reja

EPOKA E RE**Qendresa RAMA**

PRISHTINË, 28 DHJETOR - Kryetarja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Valdete Daka, ka thënë se do të jetë sfidues për këtë institucion organizimi i zgjedhjeve të parakohshme parlamentare. Daka në mbledhjen e 61-të të KQZ-së ka përmendur si problem edhe buxhetin që, sipas saj, duhet ta kenë të gjithë parasysh. Ajo ka kërkuar që data e zgjedhjeve të caktohet brenda afatit kushtetues. "Zgjedhjet janë të pashmangshme dhe ne do ta presim datën. U bëj thirrje të gjitha institucioneve të shfrytëzohet afati kushtetues për vendosjen e datës. Për ne

këto zgjedhje do të jenë sfiduese, pasi ne do të jemi i vetmi institucion që do të jemi në detyrë në ditët në vijim. Po ashtu, kemi një buxhet ende të paakumuluar", ka thënë Daka. Ylli Buleshkaj, drejtor ekzekutiv i Zyrës për Regjistrimin e Partive Politike, ka treguar se ka interesim për procedurat e certifikimit të partive. Sami Hamiti, anëtar i KQZ-së, duke folur për raportin financiar ka pohuar se është në përputhje me rregullat e KQZ-së. Ndërkaq anëtari i LV-së, Sami Kurteshi, ka kërkuar që të krijohet një aplikacion në mënyrë që lehtësohet votimi për mërgimtarët. "Një aplikacion i tillë do ta



minimizonte procesin e ripërsëritjes së numërimit", ka thënë Kurteshi. Kurse anëtari i KQZ-së nga PDK-ja, Arianit Elshani, ka

thënë se ky subjekt politik mbështet çdo iniciativë që qëllim ka lehtësimin e votimit të mërgatës. "Unë si PDK shpresoj se edhe do të krijohen

vende të rezervuara për diasporën. Unë mbështes çdo iniciativë për lehtësimin e votimit për diasporën", ka thënë Elshani.

Premtohet ndihmë financiare për gratë në biznes



PRISHTINË, 28 DHJETOR - Pavarësisht prej zhvillimeve të fundit politike, qeveria në detyrë do ta vazhdojë ndihmën për gratë në biznes. Kështu ka thënë kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, gjatë një vizite që zhvilloi të hënën në një kompani prodhuese të udhëhequr nga gratë, në fshatin Krushë e Madhe, afër Rahovecit. "Ne do të vazhdojmë zbatimin e pakos së rimëkëmbjes politike duke i mbështetur gratë në biznes. Pjesën e parë e kemi mbyllur me mbështetjen e mbi 100 çerdheve private që punësojnë gra dhe udhëhiqen nga gratë. Në pjesën e dytë do t'i mbështesim direkt gratë që janë të përfshira në biznes si pronare ose të punësuar", tha Hoti. Ndërsa Fahrije Hoti, nga kooperativa "Krusha", tha se pandemia ka krijuar vështirësi për biznesin që ajo udhëheq. "Për shkak të pandemisë kemi pasur vështirësi, por shpresojmë ta kalojmë me

sukses. Gratë e Krushës janë një shembull i mirë i gjithë Kosovës që me punën dhe përkushtimin dhe vullnetin ndaj familjes dhe fëmijëve, ato kanë siguruar një vend pune dhe vazhdojnë me punë", tha Hoti. Fshati Krushë e Madhe ka qenë një ndër vendbanimet më të goditura nga lufta në Kosovë më 1998-99. Masakra në fshatin Krushë e Madhe është më e madhja që ka ndodhur në Kosovë. Aksioni i forcave policore e ushtarake serbe në këtë fshat nisi më 25 dhe zgjati deri më 27 mars të vitit 1999. Në këtë masakër u vranë 241 qytetarë, nga ta shtatë fëmijë, pesë gra (njëra shtatzënë) dhe kanë mbijetuar 25 të plagosur rëndë. Ende vazhdojnë të jenë të pagjetur edhe 64 persona nga ky fshat. Në Kooperativën "Krusha" punojnë kryesisht gra të veja, burrat e të cilave janë vrarë gjatë luftës në Kosovë.

Naftëtarët kërkojnë shfuqizimin e dy udhëzimeve administrative

PRISHTINË, 28 DHJETOR (ER) - Shoqata e Naftëtarëve e Kosovës ka kërkuar nga kryeministri Avdullah Hoti që të shfuqizohen edhe dy udhëzime të tjera administrative, të nxjerra nga MTI-ja që, sipas kësaj shoqate, po e dëmtojnë vazhdimisht veprimtarinë e kompanive të naftës në Kosovë. Bëhet fjalë për udhëzimet e tjera administrative nr. 03/2020

dhe nr. 09/2020. Shoqata i është drejtuar me shkresë falënderuese kryeministrit të Republikës së Kosovës, Avdullah Hoti, për vendimin e miratuar në mbledhjen e qeverisë me të cilin është mundësuar shfuqizimi i pjesshëm i udhëzimit administrativ nr. 06/2019 për "Kushtet teknike për import, deponim, shitje me shumicë, shitje me pakicë të karburanteve të naftës dhe

pastrim të rezervuarve", i nxjerrë nga MTI-ja. Me këtë rast, kryetari i Shoqatës, Fadil Berjani, ka kërkuar që, përveç udhëzimit administrativ të lartcekur, të shfuqizohen edhe udhëzimet e tjera administrative nr. 03/2020 dhe nr. 09/2020, gjithashtu të nxjerra nga MTI që, sipas Shoqatës, po e dëmtojnë vazhdimisht veprimtarinë e kompanive të naftës në Kosovë.



Mbi 39 mijë është numri i të shëruarve nga Covidi në Kosovë

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike (IKShPK) ka njoftuar se të hënën në Kosovë janë shënuar edhe tetë raste të të vdekurve nga Covid-19. Në raportin ditor të IKShPK-së bëhet me dije se, bazuar në 1 002 mostra të testuara nga personat e dyshuar me Covid, 181 kanë dalë pozitive. Me shifrat e fundit, numri i përgjithshëm i të infektuarve me Covid në Kosovë arrin në 50 801. Prej tyre, 1 317 pacientë kanë vdekur dhe 39 969 janë shëruar



numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 39 969 raste, kurse numri i rasteve aktive është 9 515.

Rastet pozitive janë nga komunat: Prishtinë 78 raste, Podujevë 21 raste, Mitrovicë 17 raste, Pejë 8 raste, Gjakovë 7 raste, Gjiilan 7 raste, Fushë-Kosovë 6 raste, Drenas 5 raste, Ferizaj 5 raste, Prizren 5 raste, Vushtrri 4 raste, Deçan 3 raste, Malishevë 3 raste, Istog 2 raste, Kamenicë 2 raste, Obiliq 2 raste, Skenderaj 2 raste dhe me nga një rast komunat Kaçanik, Klinë, Lipjan dhe Shtime.

IKShPK-ja ka apeluar te të gjithë qytetarët që të vijnë të testohen për Covid sipas indikacioneve epidemiologjike, në të gjitha qendrat rajonale të shëndetësisë publike në Kosovë.

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 28 DHJETOR - Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) dhe laboratorët privatë janë testuar gjithsej 1 002 mostra të

marra nga Shërbimit Spitalor Klinik dhe Universitar të Kosovës (ShSKUK) dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilave kanë rezultuar 181 raste pozitive me Covid-19.

Brenda 24 orëve janë raportuar tetë raste të vdekjes si pasojë e këtij virusi.

Rastet e vdekjes janë nga

komunat: Pejë dy raste (80, 78 vjeç), Drenas një rast (67 vjeç), Ferizaj një rast (79 vjeç), Istog një rast (62 vjeç), Mitrovicë një rast (80 vjeç), Prizren një rast (72 vjeç) dhe Rahovec një rast (83 vjeç).

Numri total i rasteve pozitive është 50 801 raste nga 180 404 persona të dyshimtë me këtë virus dhe 1 317 raste të vdekjes.

Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 407 pacientë derisa

Nisin hetimet për hyrjen e vaksinave në veri



Prishtinë, 28 dhjetor - Prokuroria Themelore në Mitrovicë ka nisur mbledhjen e informatave rreth hyrjes së vaksinave kundër sëmundjes Covid-19 në komunat veriore të Kosovës, ka konfirmuar për "Radion Evropa e Lirë" prokurori kryesor në Mitrovicë, Shyqri Sylja. Ai ka thënë se fillimisht janë duke u zhvilluar hetimet dhe mbledhja e informacioneve, për të konstatuar nëse produktet farmaceutike kanë hyrë nga Serbia në Kosovë, përmes rrugëve joligjore ose jo. "Po hetohet fillimisht hyrja e tyre, sepse nuk mund të themi asgjë pa e ditur se si kanë hyrë, si dhe kush janë personat që i kanë sjellë ato", ka thënë Sylja. Ai ka shtuar se mundësitë për hyrjen e vaksinave nga Serbia

në Kosovë, përmes rrugëve joligjore, janë të shumta. "Nëse ne kemi prova se vërtet ato janë kontrabanduar, sepse duhet të ketë një autorizim për përdorimin e këtyre vaksinave dhe nëse ato janë të kundërligjshme, do t'i nisin procedurat penale kundër atyre personave që i kanë bërë këto punë. Hetimet penale do të nisin pas grumbullimit të hetimeve dhe, varësisht prej të gjeturave, do të fillojnë hetimet penale kundër personave që i kanë kontrabanduar", ka thënë prokurori Sylja.

Më 25 dhjetor presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, ka deklaruar se në veri të Kosovës ka filluar vaksinimi kundër koronavirusit, me vaksinën e kompanive "Pfizer/BioNTech", e cila ka arritur në Serbi para

disa ditësh.

Më 26 dhjetor, përmes një deklarate për media, Qeveria në detyrë e Kosovës ka thënë se institucionet e Kosovës nuk kanë pasur asnjë komunikim zyrtar me institucionet e Serbisë në lidhje me këtë çështje, as përmes zyrave ndërlidhëse, as me ndërmjetësimin e bashkësisë ndërkombëtare. "Nëse këto vakcina kanë hyrë në Kosovë përmes rrugëve ilegale, atëherë institucionet e Kosovës do të ndërmarrin masat e nevojshme ligjore ndaj personave të përfshirë në këtë aktivitet ilegal, kontrabandim me barna", është thënë në deklaratën e Qeverisë në detyrë të Kosovës.

Ministria në detyrë e Punëve të Jashtme e Kosovës, Meliza

Haradinaj-Stublla, ka thënë më 27 dhjetor se "hyrja ilegale në Kosovë e disa produkteve farmaceutike nga Serbia përbën shkelje flagrante të Marrëveshjes për Vulat Doganore dhe asaj për Njohjen Reciproke të Certifikatave Farmaceutike", të cilat janë arritur në kuadër të dialogut teknik në vitin 2015. "Serbia dhe zyrtarë të lartë të saj, me veprimet e muajve të fundit, si dhe me shkeljet e vazhdueshme, kanë rrezikuar sigurinë shtetërore të Kosovës dhe, rrjedhimisht, kanë nëpërkëmbur gjithë procesin dhe të arriturat e normalizimit të marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë, si në Uashington, ashtu edhe në Bruksel", ka thënë Haradinaj Stublla në një postim në "Facebook".

Sistemi shëndetësor në komunat me shumicë serbe në Kosovë funksionon brenda sistemit serb. Vakcina "Pfizer/BioNTech" ka arritur në Serbi më 22 dhjetor.

"Rel" ka marrë vesh se vaksinat nuk kanë hyrë në Kosovë përmes Entit të Shëndetit Publik, i cili funksionon brenda sistemit serb në veri.

Ministri në detyrë i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka thënë në fundjavë se Kosova, më 7 dhjetor, ka aplikuar zyrtarisht në programin COVAX, për sigurimin e vaksinës kundër sëmundjes Covid-19. COVAX është program i Organizatës Botërore të Shëndetësisë, i cili synon shpërndarjen e vaksinës kundër koronavirusit edhe në vende më të varfra.

Vazhdon ndihma për familjet skamnore në Komunën e Shtimes

SHTIME, 28 DHJETOR (ER) - Edhe pse gjatë gjithë vitit, Komuna e Shtimes ka qenë e angazhuar dhe e përkushtuar për mbrojtjen dhe ndihmën për qytetarët, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale (DSHMS), përmes Qendrës për Punë Sociale (QPS), ka shtuar aktivitetin e

vet, në këtë fund vit, që t'i ndihmojë familjet skamnore përmes pakove ushqimore dhe higjienike.

Shpërndarja e këtyre pakove po bëhet nga ekipet e DSHMS-së, të mbështetur nga QPS, të cilat u dërgohen nëpër shtëpi familjeve me nevojë. Në këtë aktivitet të hënën ka

marrë pjesë edhe drejtori i DShMS-së, Musë Baftiu dhe u. d. i QPS-së, Burim Fazliu.

Drejtori Musë Baftiu ka shprehur mirënjohjen dhe falënderoi punëtorët e QPS-së, të cilët, përveç punëve dhe detyrave zyrtare, kanë qenë të gatshëm në çdo kohë të kryejnë këto aktivitete humane

gjatë gjithë vitit, sidomos tani kur janë duke u shpërndarë 685 pako në vlerë 21039.83 euro.

Që nga fillimi i pandemisë, Komuna e Shtimes, gjegjësisht DShMS nga buxheti vetjak, ka ndarë 985 pako ndihma familjeve me nevojë, në vlerë të përgjithshme 40644.83 euro, pa

llogaritur ndihmat e tjera të ofruara nga bashkëpunimi me donatorët e shumtë, të cilët meritojnë falënderim, thotë drejtori Baftiu. Ai ka thënë se DShMS-ja mbetet e përkushtuar për përcjelljen e gjendjes sociale të familjeve me nevojë, përmes mekanizmave të vet siç është QPS-ja.



Prokurori tërhiqet nga ndjekja penale e Safet Krasniqit, shkak mungesa e provave

EPOKA E RE

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 28 DHJETOR - Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) më 24 dhjetor 2020, ka pranuar aktgjykimin me numër 2019:291344, të marrë më 11 dhjetor 2020 nga Departamenti Special pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë. Lajmi është bërë me dije nëpërmjet një njoftimi nga ATK-ja. "Në këtë aktgjykim Prokurori i Shtetit, në mungesë të provave, tërhiqet nga ndjekja penale

kundër të akuzuarit z. Safet Krasniqi, pasi nga provat e administruara nuk është vërtetuar se i njëjti ka tejkuluar kompetencat e tij zyrtare, apo që nuk i ka përmbushur detyrat e përcaktuara me ligj. Në këtë aktgjykim thuhet se z. Krasniqi nuk i ka shkaktuar dëm Buxhetit të Republikës së Kosovës. Bazuar në këtë aktgjykim është vërtetuar se zyrtari në fjalë i akuzuar ka përmbushur të gjitha obligimet ligjore dhe të gjitha veprimet janë bërë në



koordinim me prokurorin e çështjes dhe se i njëjti ka

veprimet e inspektorëve hetues", ka njoftuar ATK-ja. ATK-ja ka bërë me dije për opinionin publik se rasti ka të bëjë me aktakuzën e ngritur nga Prokuroria Speciale e Kosovës numër 09/19. "ATK njofton opinionin publik se veprimet e ndërmarra nga zyrtarët e ATK-së lidhur me këtë rast, por edhe për rastet e mëhershme të zyrtarëve të hetuar të bëra publike në media, kanë qenë në harmoni të plotë me ligjin", ka njoftuar ATK-ja.

qenë i përfshirë dhe i njoftuar për të gjitha

Buxheti i rënduar i familjeve në pandemi

PRISHTINË, 28 DHJETOR - Për familjen e Fitore Muratit, 37 vjeçe, nënë e tre fëmijëve, ishte e vështirë që ta mbyllnin muajin, pasi gjatë kohës kur në Kosovë ishin në fuqi masa të ashpra të izolimit, burri i saj u pezullua nga puna.

Të ardhurat mujore në këtë familje para pandemisë ishin 400 euro, por me largimin e bashkëshortit nga puna ata mbetën edhe pa to. Pas disa muajsh pa punë, bashkëshortin, thotë Fitorja, e kthyen në punë, por jo me pagë të njëjtë, mirëpo 100 euro më pak. Kjo e rëndoi edhe më shumë jetën e kësaj familje. "Në familjen tonë punon vetëm burri, të ardhura të tjera nuk kemi edhe atij gjatë pandemisë ia kanë zvogëluar pagën. Pandemia na ka prekur të gjithëve. Janë zvogëluar të ardhurat në familjen tonë. Pa punë dhe izolim në të njëjtën kohë", thotë ajo.

Pasi të ardhurat në familjen Murati u zvogëluar, Fitorja thotë që u detyrua të kërkojë punë si ndihmëse shtëpiake. "Edhe unë jam interesuar për punë, por pandemia mbylli të gjitha, nuk ka punë. Punoj herë pas here, jo rregullisht", thotë ajo. Fëmijët e Fitores, dy të moshës 15 dhe 16 vjeç dhe një i moshës 8 vjeç, nuk arrijnë t'i kenë të gjitha gjërat e nevojshme apo gjërat të cilat arrinin t'i kishin para pandemisë. "Shpenzimet u rritën në pandemi, pagat u zvogëluar nuk e di se si ia dalim me këto para", shton ajo.

Nga 800 euro të hyra mujore, në 400

Me një problem të ngjashëm u përball edhe familja pesanëtarëshe Selimaj. Para pandemisë gjithçka ishte mirë, thotë Agimi, kryefamiljar. Të hyrat mujore në familje ishin 800 euro pasi që punonin dy anëtarë të kësaj familjeje. Por, qysh në mars, kur qeveria vendosi masat për



Ibrahim Berisha (RFE/RL)

parandalimin e përhapjes së koronavirusit, ata mbetën pa punë dhe u rikthyen në vendet e tyre të punës vetëm pas tre muajve.

Gjatë kësaj kohe ata morën vetëm nga 170 euro dhe asgjë më shumë. "Unë dhe djali u kthyem në punë, por jo me pagat që i kemi pasur, dy herë më pak, pra nga 200 euro në muaj, nga 400 sa i kemi pasur. Puna e njëjtë e para më pak, s'e di qysh do të kalojë kjo", thotë ai.

Kjo e rëndoi buxhetin e familjes së tyre dhe gjithçka u reduktua. Shumë gjëra, thotë ai, që i kishin blerë para pandemisë, tashmë nuk arrijnë, pasi që buxheti familjar u varfërua për 400 euro në muaj. "Po të them që gjithçka ka ndryshuar, jemi krejt ndryshe sot krahasuar me para një viti. Kemi pasur kushte të mira, çfarë kam dashur kam blerë, tani jo, duhet t'i ruaj paratë, se nuk dalin deri në fund të muajit",

thotë ai. "Gjithçka ndryshoi për ne, por lutemi të jemi shëndosh dhe të kalojë kjo pandemi sa më shpejt", shton ai.

Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, nëse krahasohen çmimet e muajit nëntor 2020 me muajin nëntor të vitit të kaluar, thuhet se në përgjithësi çmimet e konsumit kanë pësuar rënie prej -0.3-përqindësh.

Rënie të çmimeve ka pasur në produktet si pemët, veshje, blerje të automjeteve, përdorim të pajisjeve për transport personal e të tjera. Por, rritje të çmimeve ka pasur në produktet e përditshme si buka dhe drithërat, mishi, qumështi, djathi dhe vezët, vajrat dhe yndyrat, perimet e tjera.

Pa të dhëna për buxhetet familjare

Institucionet në Kosovë nuk kanë publikuar ende të dhëna

të sakta se sa janë prekur buxhetet familjare. Po ashtu, nuk ka të dhëna zyrtare edhe sa është numri i qytetarëve që u larguan nga puna gjatë pandemisë.

Të dhënë të përafërta japin shoqatat ekonomike. Oda Ekonomike e Kosovës në bazë të një studimi ka thënë se janë rreth 30 mijë vende pune të humbura gjatë pandemisë, ndërkaq Sindikata e Pavarur e Sektorit Privat flet për një numër deri në 100 mijë. Por, të dhënat e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Kryqit të Kuq të Kosovës tregojnë se numri i familjeve, të cilat hyjnë në kategorinë e familjeve të varfra, është rritur gjatë kohës së pandemisë.

Sipas të dhënave të Ministrisë së Punës, gjatë pandemisë numrit të familjeve me asistencë sociale 24 229 i janë shtuar edhe më shumë se 550 familje. Shuma e mjeteve që këto familje marrin nga Qeveria e Kosovës është prej

50 deri në 150 eurosh në muaj, varësisht nga numri i anëtarëve.

Rritet numri i familjeve të varfra

Numrit prej 14 mijë familjeve të varfra të evidentuara sipas të dhënave të Kryqit të Kuq të Kosovës gjatë pandemisë i janë shtuar edhe shumë të tjera. Sipas të dhënave zyrtare, Bruto Prodhimi Vendor (BPV) për vitin 2019 ishte më shumë se 7.1 miliardë euro, kurse BPV-ja për kokë banori ka qenë 3 566 euro, përderisa rritja reale ekonomike ka qenë 4.2 për qind.

Governatori i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, Fehmi Mehmeti, ka bërë me dije se si rezultat i masave për parandalimin e përhapjes së Covid-19, ekonomia e Kosovës në vitin 2020 do të shënojë rënie deri në 7.2 për qind.

Ministria e Punës sqaron përse nuk janë ekzekutuar një pjesë e pensioneve



PRISHTINË, 28 DHJETOR - Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale këto ditë ka nisur ekzekutimin e pensioneve, mirëpo jo të gjithë kanë arritur t'i marrin këto mjete. Disa qytetarë janë ankuar se nuk i kanë marrë paratë e tyre, e për një gjë të tillë nga MPMS-ja kanë thënë se problemi është te Thesari i

Shtetit.

Në një përgjigje për "Telegrafin" nga kjo ministri kanë treguar se është bërë një gabim teknik nga Thesari i Shtetit dhe se për këtë arsye një pjesë nuk iu kanë dalë pensionet. "Është bërë një lëshim teknik nga Thesari i Shtetit dhe për këtë arsye një pjesë nuk u janë ekzekutuar

pensionet. Është duke u punuar që ky gabim të rregullohet sa më shpejt dhe të ekzekutohen mjetet për pjesën e mbetur", kanë thënë nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Qeveria e Kosovës së fundmi ka ndarë 7.5 milionë euro për subvencionimin e skemës pensionale.

Komuna e Ferizajt paraqet të arriturat, sfidat dhe sukseset për vitin 2020

FERIZAJ, 28 DHJETOR (ER) - Këtë të hënë përmes platformës zoom është mbajtur diskutimi i dytë publik në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale në Komunën e Ferizajt. Në këtë takim kanë marrë pjesë një numër simbolik i qytetarëve, ndërsa para të pranishëmve të arriturat, sukseset, por edhe sfidat i ka paraqitur nënkryetari i Komunës së Ferizajt, Arton Gavazi. "Gjatë këtij viti kemi realizuar projekte madhore infrastrukturore, ku në stad të

punimeve është 'Bashkimi i Qytetit', nënkalimi në fshatin Nikadin-Varosh, nënkalimi të 'Plus Marketi', rregullimi i trotuareve në qendër të qytetit, ndërtimi i Stacionit të Autobusëve, parku memorial i UÇK-së, nisja e punimeve për çerdhen e re në rrugën 'Rexhep Bislimi', si dhe shumë projekte të tjera", ka thënë nënkryetari i komunës, Arton Gavazi, i cili ka prezantuar edhe rreth 40 projekte të tjera madhore që janë realizuar gjatë vitit 2020 në qytetin e Ferizajt.

Në këtë takim Habib Krosa, përfaqësues i fshatit Varosh, ka paraqitur një varg kërkesash, Komunës së Ferizajt. Kërkesat e tij ishin që të ketë sa më shumë rrugë të rregulluara, të ketë më shumë trotuare si dhe parkingje në fshatin e tij. Edhe Sadik Qerimi, përfaqësues i fshatit Koshare, ka falënderuar Komunën e Ferizajt për projektet e shumta që janë realizuar në fshatin e tyre, përderisa ka parashtruar edhe kërkesa të tjera në të mirë të banorëve të fshatit të



tyre. Ndërkaq Sabedin Mustafa ka paraqitur kërkesat e banorëve të fshatit Pleshinë. Kërkesë

kryesore e tij ka qenë që të bëhet pastrimi i lumenjve si dhe të ketë edhe një mini-park në këtë fshat.

150 dhurata për fëmijët me aftësi të kufizuara në Gjilan nga bashkatdhetarët në Zvicër

GJILAN, 28 DHJETOR (ER) - Bashkatdhetarët nga Zvicra kanë dërguar 150 dhurata për fëmijët me aftësi të kufizuara në Gjilan për nder të festave të fundvitit. Në emër të bashkatdhetarëve, donacionin e ka konfirmuar të hënë bashkatdhetari Kushtrim Jetishi në takim me nënkryetarin e Gjilanit, Arbër Ismajli, i cili shoqërohej nga drejtori për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Selami Xhemali. Ismajli ka thënë se ky aksion i tyre është rezultat i atdhedashurisë dhe përkushtimit për vendin e tyre, familjet e mbarë shoqërisë. "Roli i diasporës është jetik në mbarë periudhat për zhvillimin e vendit të tyre, konsolidimit të



shtetësisë, veçanërisht për ndihmën e madhe që japin për familjet e tyre në Kosovë. Faleminderit Kushtrimit dhe mbarë shoqërisë së tij për

vullnetarizmin dhe përkushtimin për t'i gëzuar zemrat e fëmijëve tanë! Zoti ju shpërbleftë për mundin dhe sakrificën", ka thënë Ismajli.

Në Shtime pezullohen përkohësisht shërbimet në Qendrën për Regjistrim të Automjeteve

PRISHTINË, 28 DHJETOR (ER) - Ministria e Punëve të Brendshme, respektivisht Agjencia për Regjistrim Civil, njofton qytetarët e Komunës së Shtimes se janë pezulluar përkohësisht shërbimet për palë në Qendrën për Regjistrim të Automjeteve në këtë komunë. Arsyeja e këtij

pezullimi është për shkak të dyshimit të infektimit me Covid-19 të njërit prej zyrtarëve të ARC-së në Shtime, punonjës në QRA. Shërbimet për palë do të kryhen në QRA-të e regjionit. Qytetarët e Komunës së Shtimes do të informohen me kohë se kur do të rifillojë puna me këtë shërbim.



Haskuka viziton familjen Beluli, së cilës i është rindërtuar muri mbrojtës i shtëpisë

PRIZREN, 28 DHJETOR (ER) - Kryetari i Komunës së Prizrenit, Mytaher Haskuka dhe drejtori i Drejtorisë për Emergjencë dhe Siguri (DES), Faruk Dakaj, kanë vizituar banorin e fshatit Randobravë (Qëndresë), Abas Beluli, të cilit i është rindërtuar muri mbrojtës i shtëpisë së tij, në kuadër të projektit "Furnizim me material ndërtimor për intervenim në raste emergjente".

Muri mbrojtës i oborrit të shtëpisë së Abas Belulit ishte rrënuar gjatë punimeve për zgjerimin e rrugës në lagje nga qeverisja e kaluar lokale. Ky problem, përveçse rrezikonte shtëpinë e familjes Beluli nga shembja, po ashtu rrezikonte edhe jetën e banorëve të lagjes ngaqë gjasat e rrëshqitjes së dheut gjatë reshjeve ishin të larta. Me këtë rast, kryetari Haskuka ka theksuar se në këtë mënyrë

kanë vepruar edhe në shumë lokacione të ndryshme të Prizrenit, ku vetëm gjatë dy vjetëve të fundit, janë ndërtuar gjithsej 328 metra mure mbrojtëse për t'i parandaluar shembjet e dheut si dhe janë vendosur gjithsej 463 metra gypa betoni në kanale të ndryshme të rrjedhjes së ujit. Po ashtu, kryetari Haskuka ka deklaruar se kështu do të vazhdojnë të punojnë edhe gjatë vitit të ardhshëm.



Bulliqi pret përfaqësues të Këshillit të Bashkësisë Islame në Podujevë

PODUJEVË, 28 DHJETOR (ER) - Kryetari i Komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi, ka pritur të hënë një delegacion të Këshillit të Bashkësisë Islame në Podujevë, që kryesohej nga

kryetari Mensur Hoti. Gjatë takimit është biseduar për thellimin e bashkëpunimit në mes të dy institucioneve. Kryetari i Këshillit të Bashkësisë Islame të Podujevës, Mensur

Hoti, ka kërkuar përkrahje për projekte të ndryshme, me theks të veçantë për mirëmbajtjen e varrezave nëpër lokalitete të ndryshme të komunës sonë.

Kryetari Bulliqi ka falënderuar përfaqësuesit e KBI-së për vizitën dhe ka premtuar thellim të bashkëpunimit dhe përkrahjen e komunës për këtë institucion.



Vendet anëtare të BE-së mbështesin marrëveshjen me Britaninë e Madhe

BRUKSEL, 28 DHJETOR - Të 27 vendet anëtare të BE-së kanë miratuar njëzëri marrëveshjen tregtare pas Brexitit me Britaninë e Madhe, duke hapur rrugën që ajo të hyjë në fuqi përkohësisht më 1 janar. Ambasadorët e vendeve anëtare u takuan në Bruksel më 28 dhjetor për ta dhënë pëlqimin për marrëveshjen e cila përcakton kornizën për tregtinë mes Britanisë së Madhe dhe BE-së, sapo Londra të largohet nga tregu i vetëm i BE-së dhe bashkimi doganor në fund të vitit. Presidenca gjermane e BE-së tha se marrëveshja do të

miratohet me shkrim nga të 27 qeveritë e BE-së, më 29 dhjetor, një ditë para votimit nga ana e ligjvënësve britanikë. Parlamenti Evropian do të ketë kohë deri në fund të shkurtit për ta votuar dokumentin. Marrëveshja u arrit më 24 dhjetor, pas nëntë muajsh negociata të vështira midis Londrës dhe Brukselit, duke lënë shumë pak kohë që ajo të ratifikohet deri më 31 janar. Kryeministri britanik, Boris Johnson, e mirëpriti miratimin e marrëveshjes përmes një telefonate me presidentin e Këshillit Evropian, Charles Michel. "Ne mezi prisnim



ratifikimin zyrtar të marrëveshjes në mënyrë që të punojmë së bashku në përparësitë e përbashkëta, të tilla si trajtimi i ndryshimit të klimës", ka shkruar Johnson në rrjetin social "Tëitter". Rregullat e konkurrencës së

ndershme dhe të drejtat e peshkimit kishin qenë pengesa kryesore për të arritur një marrëveshje tregtare gjatë nëntë muajve bisedimesh të trazuara. Marrëveshja shmang vendosjen e tarifave, kuotave dhe pengesave të tjera tregtare që do t'u kushtonin të dyja palëve miliarda në tregti dhe qindra mijëra vende pune. Vendimi për largim të Britanisë nga BE-ja ka ardhur pasi 52 për qind e votuesve kanë votuar për dalje të Britanisë nga BE-ja kundërshtuar atë, në referendumin e mbajtur më 2016.

Policia maqedonase arreston tetë pjesëtarë të një grupi terrorist

SHKUP, 28 DHJETOR - Ministria e Punëve të Brendshme e Maqedonisë së Veriut ka njoftuar për arrestimin e "tetë personave pjesëtarë të një organizate terroriste". Sipas MPB-së, personat janë arrestuar me urdhër të Gjykatës Penale të Shkupit, pas bastisjeve të kryera në pesë lokacione dy në Kumanovë dhe tre në Shkup. Organizata terroriste, sipas policisë, ishte krijuar nga personi B. A. nga Kumanova, të cilit i ishin bashkangjitur edhe të arrestuarit e tjerë. "Të arrestuarit e tjerë, bazuar tani në matricën ideologjike të organizatës

terroriste ISIS, për kryerjen e vrasjeve dhe shkatërrimin e ndërtesave publike në mënyrë që të krijonin një ndjenjë të pasigurisë ose frikës te qytetarët, ishin gjithashtu anëtarë. Për të arritur atë qëllim, anëtarët e grupit ndërmorën disa veprime përgatitore, siguruan burime financiare dhe siguruan armë, municion, pajisje ushtarake, bën pajisje shpërthyesë të improvizuara dhe më pas i provuan duke aktivizuar mjetet shpërthyesë dhe armët me të cilat ishin pajisur", thuhet në komunikatën e MPB-së e cila nuk njofton nëse grupi i



arrestuar ka lidhshmëri me ngjarjet e fundit, përfshirë edhe sulmin në Austri. Sipas komunikatës, "anëtarët e grupit terrorist për komunikim me njëri-tjetrin kryesisht

përdorën platformën e internetit 'WhatsApp' ku, ndër të tjera, ranë dakord për mënyrën e transportimit të armëve dhe mënyrën e bërjes së rripave vetëvrasës". Aksionit i ka paraprirë një hetim i gjatë, ndërsa është ndërmarrë në bashkëpunim me Departamentin për Asgjësimin e Krimit të Organizuar - Sektorin për Luftimin e Terrorizmit, Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Radikalizmit në koordinim me Agjencinë e Sigurisë Kombëtare dhe departamentet e tjera të sigurisë.

Protesta në Mal të Zi kundër ndryshimit të Ligjit për Liritë Fetare

PODGORICË, 28 DHJETOR - Mbështetës të opozitës në Mal të Zi u mbledhën të hënën para ndërtesës së Kuvendit në Podgoricë për të protestuar kundër ndryshimeve të paralajmëruara të Ligjit për Liritë Fetare. Këto ndryshime u hartuan nga qeveria e re malazeze, me kërkesë të Kishës Ortodokse Serbe. Pjesëmarrësit me flamujt e Malit të Zi në duar u tubuan nga disa qytete. "Nuk e japim shtetin", "Çetnikë", "Kjo nuk është Serbi" janë disa

nga parullat që thirren. Nga protestuesit dëgjoheshin po ashtu sharje në drejtim të shumicës së re parlamentare dhe zëvendëskryeministrit Dritan Abazović, partia e të cilit ka thënë se do t'i mbështesë ndryshimet në Ligjin për Liritë Fetare. Komisioni për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut i Kuvendit të Malit të Zi pritet të mbajë një seancë, në të cilën do të diskutohen ndryshimet e ligjit dhe ato ndryshime më pas do të dalin në Kuvend. Ligji për Liritë



Fetare është miratuar nga qeveria e kaluar, e udhëhequr nga Marković, në fund të vitit 2019. Me këtë ligj, objektet dhe tokat fetare që kanë qenë të shtetit deri në vitin 1918, do t'i kalojnë shtetit nëse nuk ka prova se ato janë fetare. Që nga miratimi i këtij ligji, Kisha Ortodokse Serbe dhe opozita e atëhershme kanë organizuar protesta, të cilat kanë rezultuar edhe me ndryshim të qeverisë malazeze. Kisha thotë se me këtë ligj, shteti dëshiron t'ia marrë pronën.

Kroacia goditet nga tërmeti

Zagreb, 28 dhjetor - Një tërmet ka dridhur mëngjesin e së hënës pjesën qendrore të Kroacisë dhe kryeqytetin e saj, Zagreb, duke shkaktoar dëme në disa ndërtesa. Raporte për të lënduar nuk ka. Qendra Sizmologjike Evropiane-Mesdhetare tha se tërmeti e kishte fuqinë prej

5.2 shkallësh të Richterit, ndërsa epiqendrën pranë qytetit Sisak - rreth 50 kilometra në jug të Zagrebit. Tërmeti u pasua nga një dridhje tjetër, me fuqi prej 4.9 shkallësh. "Kemi tulla në rrugë dhe oxhakë të rënë", ka thënë Darinko Dumboviq, kryebashkikak i qytetit pranë,



Petrinja. Tërmeti shkaktoi dridhje edhe në Bosnje e Hercegovinë. Në muajin mars një tërmet prej 5.3 shkallësh të Richterit shkaktoi dëme të konsiderueshme në Zagreb. Një person vdiq dhe së paku 27 u lënduan.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT
PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Sot përballen Prishtina - Ponte Prizreni dhe Vëllaznimi - Ylli

PRISHTINË, 23 DHJETOR - Në mesjavë do të zhvillohet xhiroja e 12-të në Prince Caffè Superligën e Kosovës në basketboll, ku në këtë xhiro do të zhvillohen shumë ndeshje interesante. Dueli i parë është ndërmjet Sigal Prishtinës dhe Ponte Prizrenit. "Bardhekaltrit" do të përpiqen ta ndalin serinë e fitoreve të prizrenasve, që ka shkuar në gjashtë. Ponte ka treguar ndeshje të mira në xhirot e fundit, duke qenë në vendin e parë me Rahovecin me tetë fitore dhe tri humbje, kurse prishtinasit kanë tri fitore dhe tetë humbje. Të martën përballen edhe Vëllaznimi-Golden Eagle Ylli. "Kuqezinjët" kanë katër fitore dhe shtatë humbje, derisa therandasit gjashtë fitore dhe pesë humbje, andaj pritet një



takim interesant. Rahoveci dhe Bashkimi, që janë në formë të mirë në xhirot e fundit, do të ndeshen të mërkurën. "Vreshtarët" humbën nga Ponte Prizreni në xhiron e fundit, por kanë pikë të njëjta me Ponten, kurse "Portokallezinjtë" ndodhen në

formë shumë të mirë dhe pas Pejës kërkojnë fitoren edhe ndaj Rahovecit. Bashkimi ka gjashtë fitore dhe pesë humbje. Peja - Trepça është sfida e fundit e kësaj xhiro. Skuadrat me traditë në basketbollin e Kosovës pritet të dhurojnë një ndeshje të bukur të mërkurën.

Pejanët kanë shtatë fitore dhe katër humbje, kurse mitrovicasit dy fitore dhe nëntë humbje, duke qenë skuadra e fundit për momentin në renditje.

Xavier Cannefax, MVP i xhiros 11

Ponte Prizreni po vazhdon me fitore në Prince Caffè Superligën e Kosovës në basketboll. Kësaj radhe prizrenasit kanë mundur Rahovecin me rezultat 88:82. Më i merituari për këtë fitore ishte Xavier Cannefax me 34 pikë, tri kërcime dhe dy asistime, me një indeks prej 34. Ai edhe në momentet vendimtare të ndeshjes tregoi klasën e tij, duke i dhuruar skuadrës së tij një fitore shumë

të rëndësishme. Xavier ishte i pandalshëm në këtë ndeshje, duke qenë enigmë për Vreshtarët, që shkaktuan 10 faulle ndaj tij. Ndërkohë, top pesë shënuesit e kësaj jave janë Xavier Cannefax i Ponte Prizrenit me 34 pikë, Dion Dixon i Pejës me 31 pikë, Cendrik Council i Vëllaznimit me 30, Christophert Hortman i Vëllaznimit me 25 dhe Tramaine Isabell i Trepçës me 25.

Prince Caffè Superliga - Java 12

Të martën takohen:
13:00 Sigal Prishtina - Ponte Prizreni
15:00 Vëllaznimi - Golden Eagle Ylli

Të mërkurën takohen:
13:00 Rahoveci - Bashkimi
15:00 Peja - Trepça

Challandes: Isha i dëshpëruar pas humbjes nga Maqedonia

CYRË, 28 DHJETOR - Përzgjedhësi i Përfaqësueses së Kosovës, Bernard Challandes, në një intervistë për "Le Temps" ka treguar sfidat kundër Covid-19 dhe vështirësitë që u përball zvicëranit në krye të "dardanëve". "Sa i përket jetës sime, nuk më ka ndikuar shumë sepse unë jetoj në periferi. Por si baba i një familje, gjysh i nipërve, kam qenë i qetë", ka thënë ai. Zvicëranit foli edhe për Kosovën, ku veçoi ndeshjen me Maqedoninë. "Në aspektin profesional isha i frustruar, sepse ne kishim vetëm një qëllim këtë vit, fitore në ndeshje me Maqedoninë. Kishim përgatitur këtë ndeshje për tre vjet dhe e humbëm. Unë brengosësia duke bërë telefonata dhe duke folur me mjekë të futbollit, por dita erdhi dhe ne mbetëm pa tre lojtarët kryesorë. Situata ishte ashtu. Nëse jetoje në Muni




mund të vije, nëse jetoje në Bremen, jo. Maqedonia kishte komplet ekipin, isha i dëshpëruar, tejet i zhgënjyer", ka thënë 69-vjeçari. Ai u ndal të flasë edhe për kualifikimet për botërorin 2022. "Po, do të luajmë. Vetëm nëse situata pandemike dhe shëndetësore përkeqësohet.

Nëse je në Prishtinë brohoriteni dhe përshëndeteni nga 13 mijë persona, njerëz në rrugë, ne kafene është e mahnitshme të përjetohet. Me publikun jemi më të mirë. Shpresoj të jenë të pranishëm. Nëse jo, vetëm mund të them se nuk është i njëjti sport pa ta", ka përfunduar Challandes.

Khaka: Gjithmonë e tregoj karakterin tim

LONDËR, 28 DHJETOR - Granit Khaka ka përfunduar në qendër të kritikave pas një kartoni të kuq që mori në duel me Burnleyn. Mesfushorin shqiptar e tradhtuan nervat pasi kapi për fyti një kundërshtar dhe mori karton të kuq. Tifozët, drejtuesit e klubit, por edhe ish-lojtarët filluan ta kritikonin duke thënë se ai ishte një gjest i keq. Gjithsesi Khaka u rikthye pas suspendimit dhe shënoi një gol të jashtëzakonshëm ndaj Chelseat në fitoren e skuadrës së tij 3-1. "Kishte shumë fjalë pas atij kartonit të kuq, shumë njerëz filluan të flisnin përsëri dhe përsëri. Por, unë e tregoj gjithmonë karakterin tim", ka thënë Khaka. "Unë isha shumë i zhgënjyer për atë karton të kuq dhe e di se



bëra një gabim ndaj ekipit tim. Por, jam më se i lumtur që ndihmova ekipin në kthimin tim. Morëm tri pikë pas kemi lënë disa në ndeshjet e fundit. Punuam si skuadër dhe vetëm kështu mund të marrim pikë", ka shtuar Khaka.

Shkëmbi zëvendëson Munishin te Ballkani

SUHAREKË, 28 DHJETOR - Trajneri nga Shqipëria, Bledi Shkëmbi, është emëruar trajner i ri i skuadrës së Ballkanit nga Suhareka. Shkëmbi do të jetë pasardhës i Ismet Munishit i cili u shkarkua javën e kaluar. "Kemi arritur marrëveshjen me

trajnerin nga Korça, Bledi Shkëmbi. Pas shumë negociatave me trajnerë të respektuar, të cilët i kemi kontaktuar dhe të cilët i falënderojmë për shpalljen e programeve të tyre dhe vullnetin për të bashkëpunuar. Mirëpo, ai i

cili na bindi për një bashkëpunim të ardhshëm tashmë është timonieri më i ri FC Ballkani, Bledi Shkëmbi. Shkëmbi ka drejtuar skuadrën KF Teuta (Durrës) dhe Liria FC (Prizren) andaj kjo është prova e tij e dytë në Superligën e Kosovës.

Na priftë e mbara Bledi Shkëmbi! Na priftë e mbara Suharekë!", thuhet në njoftimin e FC Ballkani. Shkëmbi në Shqipëri ka drejtuar skuadrën e Teutës së Durrësit, kurse në Kosovë e ka drejtuar Lirinë e Prizrenit në edicionin 2017/2018.




Haki Kameraj dhe Blerta Terpeza, fitues të kampionatit të parë në pikado

PRISHTINË, 28 DHJETOR - Kampionati i parë i Kosovës në pikado është mbajtur në fundjavë. Haki Kameraj i Klubit "Bullsey" doli triumfues në kategorinë e meshkujve, kurse

në konkurrencën e femrave Blerta Terpeza e KP Ferizajt. Në konkurrencën e meshkujve morën pjesë 32 garues, kurse Haki Kamberaj pati paraqitje shumë të mira dhe në final me

plot meritë e mposhti Shpend Gashin e KP Ferizajt, kurse në vendin e tretë është renditur Selami Latifi i klubit KP Lipjan. Në konkurrencën e femrave pjesëmarrëse ishin 16 garuese

dhe Blerta Terpeza e mposhti në finale Semra Abdullahin e KP Darts Girl Prishtina. Në vendin e tretë është renditur garuesja e KP Shooters Gjilan, Fjona Xhelili.



Messi e përjashton transferimin te Reali



BARCELONË, 28 DHJETOR - Manchester City dhe PSG-ja janë dy klube që ndjekin prej kohësh Leo Messin, por ylli argjentinas ka konfirmuar se nuk do të largohet nga Barça deri në fund të sezonit. "Do të pres fundin e sezonit. Për momentin gjëja më e rëndësishme është skuadra. Nuk duhet të shpërqendrohet nga këto gjëra. Di që shumë persona te Barcelona dëshirojnë të qëndrojnë, disa të tjerë

dëshirojnë të largohem, por do të bëj atë që është më e mira për klubin dhe për mua, nuk kam dyshime. Në fund do të bëj atë që më thonë zemra dhe mendja", u shpreh Messi duke përjashtuar më pas në mënyrë të prerë mundësinë për një transferim te Real Madridi. "Kjo është e pamundur. Një ditë do të më pëlqente të luaja në ShBA", ka thënë ai. Në intervistën Messi nuk u shpreh i bindur se do të vijojë të

qëndrojë në Barcelonë, qytet dhe ekip ku për 16 vjet ka përjetuar gjithçka: "Është një histori e vogël dashurie me qytetin dhe klubin. Të përfundoj si të përfundoj, asgjë nuk mund t'i fshijë 16 vite si profesionist. Nuk është e lehtë të qëndrosh në një klub për një kohë kaq të gjatë. Ka pasur edhe momente të vështira, edhe shumë të vështira, por gjithçka është kaluar. Të shohim tani në fund".

Clippersat 'turpërohen' nga Dallasi, Lakersat pa problem mposhtin Minnesotan

DALLAS, 28 DHJETOR - Surprizën më të madhe në mbrëmjen e NBA-s e dhuroi Dallas Mavericksi me skuadrën teksane që triumfoi brenda në Kaliforni përballë Los Angeles Clippersit me rezultatin e thellë 124-73. Mungesa e Kawhi Leonardit u ndje shumë te Clippersi i cili pësoi humbjen më të thellë në historinë e NBA-s për sa iu përket pjesëve të para, teksa vetëm pas 2 periodave Luka Donçiq me shokë kryesonin me 50 pikë epërsi, diçka e paimaginueshme pas vetëm 24 minutash lojë. Në fund, falë edhe 24 pikëve të realizuara nga Donçiq Dallas, mori fitoren e parë në këtë sezon të NBA-s, duke u shkaktuar Clippersave disfatën e parë që ishte vërtet e turpshme me 51 pikë diferencë, raporton "Supersport". Fitorja e dytë rresht për Los Angeles Lakersin dhe e dyta sezonale me



kalifornianët që kaluan pa probleme Minnesota Timberwolvesin me rezultatin e thellë 127-91. Në mungesë të Anthony Davis më i miri mbi parket për kampionët në fuqi të NBA-s ishte Kyle Kuzma me 20 pikë. Falë një super Stephen Curry, autor i 36 pikëve, regjistroi suksesin e parë sezonal edhe Golden State Warriors që triumfoi në transfertën ndaj

Chicago Bullsit me rezultatin 129-128. Pësoi humbjen e parë Brooklyn Nets që u mposht në transfertë me rezultatin 106-104 nga Charlotte Hornets. 29 pikët e Durantit ishin të pamjaftueshme për skuadrën nju-jorkeze. Rezultat surprizues mund të konsiderohet edhe humbja e Milwaukee Bucksit në Madison Square Garden ndaj New York Knicksit me rezultatin 130-110.

SHKURT

Federeri për herë të parë mungon në Australian Open

Gjashtë herë kampioni Roger Federer do të mungojë në Australian Open për herë të parë në karrierë, sepse është duke vazhduar riaftësimin nga operimi në gju. Tenisti 39-vjeçar, fitues i 20 titujve grand slam, nuk ka luajtur që prej janarit për shkak të dy ndërhyrjeve kirurgjike në gju. Zvicerani shpresonte se do të rikthehej në fushë në grand slam-in e parë të vitit, Australian Open, i cili u shty për 8 shkurt. Megjithatë, ai nuk ia ka dalë mbarë të shërohet për të marrë pjesë në turneun e Melbourne. "Rogeri nuk pati për t'u përgatitur për turneun e vështirë grand slam", ka thënë drejtori i Australian Open, Craig Tiley. Federeri luajti në Australian Open 21 vjet radhazi, por menaxheri i tij ka thënë se mungesa e tij në këtë turne është vendimi më i mirë afatgjatë.

Haalandi zbulon tre mbrojtësit më të fortë

Erling Haaland po kalon pushimet në vendlindje. Sulmuesi i Borussia Dortmundit humbi takimet e fundit të vitit për shkak të një problemi muskolor. 20-vjeçari ka dhënë një prononcim për mediat norvegjeze, aty ku flet rreth mbrojtësve më të fortë në botën e futbollit. "Tre më të fortët janë Sergio Ramos, Virgin Van Dijk dhe Kalidou Koulibaly. Janë të ashpër, por shumë inteligjentë", ka deklaruar Haaland.

Interi synon transferimin e Origit

Interi është i gatshëm të bëjë një lëvizje për sulmuesin e Liverpoolit, Divock Origi në janar. "Il Corriere dello Sport" pretendon se Interi po kërkon një alternativë të re për sulmin dhe Origi përmendet si një kandidat i mundshëm për ta zëvendësuar Romelu Lukakun kur të paraqitet nevoja. Një largim nga Liverpooli thuhet se është një mundësi konkrete, pasi ish-sulmuesi i LOSC Lille ka nevojë për minuta përpara "Euro 2020". Kontrata e Origit skadon në qershor të vitit 2024 dhe vlera e tij aktuale e tregut përcaktohet në 16 milionë euro.

Mourinho: Ndaj Wolvesit na mungoi ambicia për fitore

Tottenham Hotspur mbeti baras 1-1 me Wolvesin. Trajneri Jose Mourinho nuk e fshehu zhgënjimin në fund të sfidës për një fitore që i shpëtoi nga duart serish. "Një pikë ndaj Wolvesit normalisht nuk do të ishte e keqe, pasi ata janë një ekip i fortë. Por të shënosh gol në minutën e parë dhe të kesh 89 minuta të tjera kohë për të mbyllur ndeshjen dhe të mos e bësh, atëherë zemërohesh. Ekziston ndjenja e zhgënjimit. Tani kemi një mundësi tjetër ndaj Fulhamit, që është një skuadër që po luan mirë. Do të jetë një sfidë e vështirë. Kemi luajtur kohët e fundit me ekipe të mëdha, tani nuk do ta kemi të thjeshtë ndaj Fulhamit dhe Leedsit. E njoh mirë skuadrën time. Askush nuk e njih më mirë se unë. Ndaj Wolvesit na mungoi ambicia për të bërë diçka më shumë", ka thënë Mourinho.

Pochettino emërohet trajner i PSG-së

PSG-ja e shkarkoi Thomas Tuchel pak ditë më parë dhe zgjodhi Mauricio Pochettinon trajner të ri. Në garë ishte edhe Max Allegri, madje italianin ishte dëshira kryesore e Leonardos, drejtorit sportiv të kampionëve të Francës. Gjithsesi, pajtimi nuk u arrit dhe dy janë shkaqet. "Le Parisien" raporton se drejtuesit e PSG-së u frenuan nga kërkesat e larta financiare të Allegrit. Ky i fundit kërkonte një rrogë prej 12 milionë eurosh në sezon (Tuchel përfitonte 7.5). Edhe lojtarët nuk ishin entuziastë dhe mendonin se ish-trajneri i Juventusit dhe Milanit nuk do të sillte ndonjë gjë më të mirë se Tuchel. Në kushte të tillë u zgjodh Pochettino. Ky i fundit e njih mirë ambientin dhe gjuhën franceze. Trajneri argjentinas, i cili si futbollist luante si qendërmbrojtës, është aktivizuar për dy sezone me PSG-në (2001-2003).

Rrallëherë ndodh që lexuesi, pasi ta ketë lexuar librin, të marrë informacion, të gjejë thellësi mendimi, shqyrtim profesional dhe njerëzor të një krijimtari filmike sikurse i merr dhe i gjen në librin e Agron Shalës. Njëjtë si Kieślowski që i linte të hapura veprat e tij, Shala nuk pretendon të mbyllë asgjë por, duke shqyrtuar në dimensionin artistik, politik, fetar e njerëzor, hap mundësi të reja interpretimi për dekalogun e ditëve tona.

Zymer Kelmendi

Ky libër është interpretim për dramën serike "Dekalogu" të regjisorit Krzysztof Kieślowski, i ndërthurur me një egzekjez të lirë autoriale të veprave të kulturave të lashta, ku nuk mungojnë as analiza psikologjike e etike që lidhen me karakteret dhe veprimet e protagonistëve të dramës, por edhe me jetën dhe besimin e shqiptarëve sot. Një libër i shkruar me një gjuhë të rrjedhshme, që me çdo fjali të shtyn ta lexosh më tutje. Konsideroj se ky libër përbën një kontribut të pasur shkencor në opusin e kritikës së veprave artistike.

Kristë Shtufi

Një libër që zbërthen relacionet e njeriut me fenë dhe Zotin, që bazohet në një vepër filmike, por që përçohet te ne nëpërmjet urdhrave biblike. Autori në mënyrë të mprehtë dhe me delikatesë e ndërlidh temën e besimit në Zot, ekzistencën e religjioneve të shqiptarët, duke bërë ndarjen mes fesë dhe identitetit kombëtar. Shkurt, ky është një libër i shkruar me kujdes, me një gjuhë të pastër dhe krejtësisht intelektuale, e që do të duhej të lexohej nga secili.

Fadil Sahiti

... përmes mikrobotës së Kieślowskit, "Dekalogu" i Agron Shalës na dëshmon se mund të ringjallet metamorfoza progresive e mendjes tonë...

Orhan Kerkezi

Kur shikohet "Dekalogu" i Kieślowskit dhe kur lexohet libri i Shalës, kuptohet thënia se 'thjeshtësia është madhështi'.

Daut Dauti

ÇMIMI: 5.99 €



9 789951 780377


AGRON SHALA | DEKALOGU | NGA MOISIU DERI TE KIEŚLÓWSKI



AGRON SHALA

DEKALOGU

nga Moisiu deri te Kieślowski



Daut Dauti është historian, gazetar publicist dhe prozator. Ka kryer studimet në Fakultetin Juridik në Prishtinë, ka magjistruar në West London University në degën e Studimeve Evropiane, kurse ka doktoruar në University of Leeds në shkollën e njohur të historisë të këtij universiteti.

Në fund të viteve '80 ka filluar të merret me gazetari. Shkrimet e para i ka botuar në gazetën e studentëve *Bota e re*, pastaj në revistën *Zëri*. Nga viti 1994 deri më 1999 ka qenë korrespondent i *Zërit* nga Londra. Në vitin 1999 ka filluar të punojë në redaksinë IWPR (Institute for War and Peace Reporting) dhe në këtë vit ka themeluar zyrën e këtij instituti në Prishtinë.

Nga viti 1999 deri më 2002 ka qenë sekretar dhe ndër themeluesit e Shoqatës së Gazetarëve të Kosovës dhe ka shërbyer anëtar i Këshillit Qendror të Zgjedhjeve. Gjatë vitit 2002 në institutin amerikan *Kettering Foundation* ka hulumtuar temën e mediave të pavarura dhe që nga ky vit është anëtar i ekipit hulumtues-studiuës i këtij instituti. Dauti ka punuar në disa organizata të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare. Ka qenë dhe zëdhënës i Qeverisë së Kosovës në vitin 2005.

Daut Dauti është autor i disa librave dhe punimeve shkencore. Punimet e tij me temë nga fusha e historisë, e gazetarisë dhe e letërsisë janë botuar në mediat shqipe dhe në revista të njohura ndërkombëtare.

Një palë këpucë në Berlin është novela e tij e parë.

4.99 €



9 789951 780100

Daut Dauti

Daut Dauti
NJË PALË KËPUCË NË BERLIN

novelë





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCES

AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr: 493/1
Dt: 28.12.2020

Në bazë të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr.04/L-032, Neni 4 dhe 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional 04/L-138, Neni 13 dhe 34, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2012 (Neni 4), Udhëzimit Administrativ Nr. 10/2018, Udhëzimit Administrativ 05/2015, Udhëzimit Administrativ 07/2017 si dhe në bazë të kërkesave të shkollave, Agjencioni për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur shpall:

RI-SHPALLJE E KONKURISIT

Në Qendrën e Kompetencës në Skenderaj për vitin shkollor 2020/2021

Niveli	Institucioni/Shkolla	Vendi	Pozita/Vend i ilirë	Vendi lirë/ Zëvendësim
SHML	Qendra e Kompetencës	Skenderaj	Një(1) mësimdhënës/e për lëndën Biznes dhe ndërmarrësi me normë të plot;	Zëvendësim

Detyrat dhe Përgjegjësitë për mësimdhënës të nivelit të IV-të;

- Mësimdhënësi është i obliguar ta realizojë planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/ saj të punës.
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies.
- Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e planprogramit të ri.
- Të tregojë respekt dhe të silltë me drejtësi e pa dallime me njerëzit me të cilët punon.
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrtarit të cilit i raporton dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ua caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.
- Nuk mund të kërkojë apo të pranojë udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç Organit Drejtues të Qendrës Kompetencës dhe AAAPAR-së.
- Nuk lejohet shfrytëzimi i pozitës për përfitime private në dobi të ndonjë pale të tretë.
- Diagnostifikon kushtet për mësim dhe procese mësimore të nxënësve përmes proceseve të përshtatshme dhe reagon në mënyrën e duhur ndaj tyre, duke filluar masa të ndryshme mbështetëse individuale ndaj nxënësve.
- Puna monitorohet dhe vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të nxënësve sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës.

Kualifikimi dhe shkathtësitë e kërkuara për mësimdhënës:

- Diploma e përgatitjes profesionale e nivelit të 7 sipas KKK;
- Letërnjoftimi (fotokopje);
- Certifikata për trajnimet e kryera;
- Vërtetimin e përvojës punës në arsim;
- Për të gjitha vendet e shpallura në konkurs kërkohet për gatitja adekuate profesionale;
- Ai ose ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën tryzni, të ketë etikë të lartë të punës dhe shkallë të lartë integriteti;

Procedurat e konkurrimit:

Afati i konkurrimit është 7 ditë pas shpalljes. Aplikacionet dhe dokumentet e kërkuara duhet të merren dhe dorëzohen në administratën e institucioneve në të cilat është shpallur konkursi gjegjësisht në Qendrën e Kompetencës në Skenderaj.

Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin (për të diplomuarit jashtë vendit dëshmitë e nostrifikimit të diplomës), dëshmia për përvojën e punës, dëshmia që nuk janë nën hetime dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkohen për vendin e punës.

Kërkesat e arritura pas mbylljes së konkursit, dhe aplikacionet e pa kompletuara nuk shqyrtohen. Kandidatët të cilët do të ftohen në intervistë duhet t'i sjellin në shikim dokumentet origjinale.

Kompania Regjionale e Mbeturinave "Ambienti" Sh.A. Pejë



Bazuar në Ligjin e Punës Nr.03/L-212 të dt. 02.11.2010. dhe neni 8. të dhe në bazë të Udhëzimit Administrativ Nr. 07 / 2017. Kryeshefi Ekzekutiv i K.R.M. Ambientit SH.A. Pejë publikon këtë

KONKURS

Pozita: 1- Punëtor Sigurimi (Roje) në Njësinë Operative në Pejë

Detyrat dhe përgjegjësit:

-Përcjell hyrje-daljen e palëve, punëtorëve dhe automjeteve

- Daljen e punëtorëve pa leje paraprake, të parakohshme i evidenton në libër të vecant.
- Palët duhet t'i japë fletëhyrjen dhe i orienton për në shërbimet për të cilat janë të interesuara.
- Është i obliguar për sjellje korrekte me pale dhe për qëndrim në vendin e tij të punës
- Bënë sigurimin e objektit në të cilin është përcaktuar në bazë të planit mujor
- Kryen edhe punë tjera me urdhër të shefit të sigurimit dhe Sekretarit-

Pozita :3- Punëtor Fizik

Detyrat dhe përgjegjësit:

- Kryen të gjitha punët në mbledhjen dhe ngarkimin e hedhurinave.
- Mbledh hedhurinat dhe bënë zbrazjen e Kontenjerëve dhe mjeteve tjera për hedhurina apo çesëve nga shfrytëzuesit të shërbimeve në sektorin privat dhe shtetëror.
- Për punën e tij i përgjigjet Kryeshefit ekzekutiv dhe Menzherit të njësisë në Pejë

Procedurat për aplikim:

-Aplikacionet merren në zyrat e KRM AMBIENTIT SH.A.

Kandidatët e interesuar duhet t'i sjellin keto dokumenta për aplikim

- Diplomën e shkollës së mesme ndërsa për punëtor Fizik e mjaftueshme Shkolla Fillore
- Biografinë (CV) e detajuar
- Çertifikatën që nuk është nën hetime
- Letërnjoftimin

Dokumentet përcjellëse dorëzohen në Arkivën e kompanisë në pliko të mbyllur në zyrat e Njësisë Operative Ambienti në Pejë.

Pozita – kerkohet me kohë të caktuar ,dhe me pune provuese prej 6 muajesh

Kandidatët të përzgjedhur në Listën e ngushtë do të informohen me shkrim ose me telefon në afat ligjor, dhe të njëjtit janë të obliguar të sjellin dokumentet origjinale mbi kualifikimet dhe trajnimet e kryera për verifikim para Komisionit intervistues. Afati për dorëzimin e aplikacioneve është 15 ditë nga dita e publikimit të konkursit deri më, të ditës gjegjëse.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të cekur me lartë dhe dokumentet jo të kompletuara do të refuzohen.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Fatos Gashi shpalle të pavlefshme diplomën e SHMLM " Dr. Xheladin Deda".

► Kaltrina Jashari shpalle të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore " Harun Beka".

► "Berlin Chemia/A. Menarini Kosovo" L.L.C. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 811159442.

► Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Feja", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Feja" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokal me qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

